

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

Sezoni 2025-2026

✓ Dokumentacioni për aplikimin për regjistrim në çerdhe dhe aplikimin për regjistrim në kopsht

Për aplikuesit që vijnë nga shtresat social-ekonomike në nevojë, referuar kategorive vulnerabël sipas VKB-së Nr.158, datë 26.12.2019 “Për miratimin sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, kriteret dhe dokumentacioni i duhur, për secilën kategori, si më poshtë vijon:

1. Fëmijë me statusin e jetimit

- Libreza e statusit të jetimit të fëmijës
- Certifikata personale e fëmijës dhe familjare

2. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit

- Libreza e statusit të kujdestarit ligjor të fëmijës
- Certifikata personale e fëmijës dhe familjare

3. Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor

- Raporti mjeko-ligjor i fëmijës
- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës

4. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor

- Raporti mjeko-ligjor i kujdestarit ligjor të fëmijës
- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës

5. Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim nga Njësia Administrative për trajtimin me ndihmë ekonomike të kujdestarit ligjor

6. Fëmijët e familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim page i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë.
- Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin nga portali zyrtar e-albania

7. Fëmijët e familjeve, ku kujdestari ligjor i fëmijës, është i divorcuar ose i ve, (sipas certifikatës së gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë, vërtetuar me dokumentacionin përkatës

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim page i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë.
- Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin nga portali zyrtar e-albania

8. Fëmijë të familjeve të pakicës rome dhe egjiptiane, sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ose vetdeklarimi ku përcaktohet se familja është pjesë e këtyre pakicave

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ose vetëdeklarim

9. Fëmijët e vendosur në kujdestari nga familjet kujdestare, sipas legjislacionit në fuqi, vërtetuar me dokumentacionin përkatës

- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës
- Vendimi i gjykatës për dhënien e kujdestarisë

10. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I DUHUR PËR KATEGORITË E TJERA

- Certifikatë personale dhe familjare e fëmijës
- Vërtetim me të ardhurat mujore nga paga të prindërve (kujdestarëve ligjor)
- Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësorë për Individin-E-SIG 03/a të prindërve (kujdestarëve ligjor)
- Kartela personale e vaksinimit për fëmijën

Dokumentet mund të shkarkohen nga portali zyrtar e-albania

Sqarim: Kartela personale e vaksinimit duhet të ngarkohet për secilën kategori. Për çerdhen është kriter frekuentimi, ndërsa për kopshtin është kriter regjistrimi dhe frekuentimi.

✓ **Dokumentacioni për kalimin e fëmijëve nga çerdhja në kopsht**

Ky aplikim mund të realizohet për fëmijët që janë aktualisht të regjistruar në çerdhet publike dhe mbushin 3 vjeç deri në datë 15 Shtator 2025.

Dokumentacioni i duhur për këtë aplikim:

- Certifikatë personale e fëmijës
- Certifikatë familjare
- Dokumente të tjera të cilat vërtetojnë banesën afër kopshtit të kërkuar (vërtetim banimi/kontratë blerje banese etj).

✓ Dokumentacioni për aplikimin për transferim në çerdhe tjetër dhe aplikimin për transferim në kopsht tjetër

Ky aplikim mund të realizohet për fëmijët që janë aktualisht të regjistruar në çerdhe apo kopshte publike.

Dokumentacioni i duhur për këto aplikime:

- Certifikatë personale e fëmijës
- Certifikatë familjare
- Dokumete të tjera të cilat dokumentojnë arsyen e kërkesës për transferim.

Faleminderit për mirëkuptimin!